



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:120355

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05860850

Ac.nr.3780/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Nora Bllaca Dula e Fatmir Baloku, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen kontestimore të paditësit S. Sh nga Gjilani, kundër të paditurës M. P nga Gjilani, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të blerjes, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.616/2018 të datës 12.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si e bazuar, ankesa paditësit S. Sh nga Gjilani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.616/2018 i datës 12.03.2021, PRISHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje të serishme.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, hudhet si e palejuar, kërkesëpadia e paditësit S. Sh nga Gjilani, e ushtruar kundër të paditurës, M. P nga Gjilani, për lëndën civile C.nr.616/18, për shkak se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi.

Kundër këtij aktvendimi, ankesë ka parashtruar paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit, të ndryshohet, duke aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, apo i njëjti të priset dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, paditësi S. Sh ka parashtruar padi ndaj të paditurës M. P, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se F. Sh është pronar i paluajtshmerisë 03994-0 me kulturë shtëpi oborr në sipërfaqe prej 0.01.65 ha e cila gjendet në vendin e quajtur "...". Paditësi ka theksuar se e paditura paluajtshmerinë kontestuese ia ka shitur paditësit në bazë të kontratës në vitin 2002 të përpiluar nga i ndjeri avokat H. S dhe dëshmitarëve S. Sh dhe F. Sh duke e përmbushur në tërsi çmimin shitblerjes prej 35,000 DM dhe të paditurën e kishte lejuar të qëndroj në këtë shtëpi derisa ajo të blen shtëpi apo ndonjë banesë dhe paditësi paluajtshmerinë kontestuese me kalimin e kohës ia ka bart djalit F. Sh, ndaj kësaj shitblerje e paditura M. P ka ushtruar padi për anulimin e kontratës së shitblerjes Vr. Nr. 8501/2010 e datës 03.11.2010, e cila kontratë është lidhur në mes paditësit S. Sh dhe F. Sh, ku në bazë të kësaj kontrate është bërë ndërrimi i pronarit tek Drejtoria Për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Gjilan. Gjykata Themelore në Gjilan me Aktgjykimin C.nr.338/2013 të datës 28.04.2017, ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e tani të paditurës M. P nga Gjilani, ndaj të paditurit F. Sh nga Gjilani dhe ka anuluar kontratën mbi shitblerjen e pasurisë së paluajtshme në ngastrën Kadastrale 03994-0 me kulturë shtëpi, oborr në sipërfaqe prej 0.01.65ha e cila gjendet në vendin e quajtur "... " e regjistruar në emër të F. Sh sipas certifikatës nr.4037-2013 e lëshuar me datë 25.04.2013. sipas shkresave të lëndës, kjo çështje gjendet me ankesë në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë, me arsyetimin se mungon interesi juridik i paditësit lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: "Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji".

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:c) ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit e Kosovës përfundimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta pranoj si të ligjshëm dhe të drejtë dhe konsideron se aktgjykimi i atakuar, është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 99 dhe 102 të LPK-së dhe nenin 182 par.2 pikën n), për arsye se aktvendimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, nuk janë dhënë arsye të plota mbi faktet vendimtare.

Kolegji gjen se në këtë çështje gjykata e shkallës së parë ka marrë aktvendimin me të cilin ka konsideruar që palës paditëse i mungon interesi juridik meqë paluajtshëmria është e evidentuar në emër të djalit të paditësit F. Sh. Sipas vlerësimit të kolegjit gjykata e shkallës së parë nën kushtet kur veç paluajtshëmria ka qenë e evidentuar juridikisht në emër të djalit të paditësit, ka qenë dashur që ta ftoj palën paditëse që të bëj rregullimin e padisë dhe të qartësoj kërkesëpadinë si në pikëpamje të objekti të kontestit e poashtu edhe në pikëpamje të legjitimitetit të palëve në procedurë, pasi veç e paditura M. P tanimë veç nuk e ka pasur të evidentuar paluajtshëmriinë kontestuese në emrin e saj. Këto të meta, ka qenë dashur që gjykata të ndërmerr veprime dhe të kërkojë nga paditësi që ti evitoj në fazën përgatitore ku edhe zhvillohen veprimet lidhur me mirë përgatitjen e procesit kontestimor dhe ku do të ndërmerreshin veprimet ligjore konform nenit 99 dhe 102 të LPK-së dhe që të mos vazhdohet me procesin kontestimor, duke pasur para vetes një kërkesëpadi të pa qartë në këtë rast.

Për arsyet e sipër theksuara kolegji gjen se qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit dhe që çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në procedurën e rigjyimit gjykata e shkallës së parë udhëzohet që t'i ndërmarr veprimet nga neni 99 dhe 102 të LPK-së, lidhur me qartësinë e kërkesëpadiisë me qëllim të eliminimit të të metave në drejtim të përcaktueshmërisë së kërkesave dhe ekzistimit të legjitimitetit apo interesit juridik. Kjo sepse, kërkesëpadiia është pjesa qendrore e kërkesëpadiisë lidhur me të cilën do të duhet të vendos gjykata për kërkesat e palëve në procedurë. Paqartësia dhe pa përcaktueshmëria e kërkesëpadiisë e bënë padinë të mangët në pikëpamje formale dhe kjo rrethanë e pamundëson punën e gjykatës lidhur me të.

Gjykata e shkallës së parë të bëjë vërtetimin e fakteve të tjera relevante në procedurë, dhe pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe aplikimit të drejtë të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së parë do të marr një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj, në këtë çështje kontestimore.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3780/2021, me datë 24.06.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj